



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Abertis Infraestructuras S.A / A4 Holding S.p.A

Në datën 27 Maj 2016, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Marrëveshjeve për Shitjen dhe Blerjen e Aksioneve” të nënshkruara përkatësisht ndërmjet shoqërisë Abertis Infraestructuras S.A dhe aksionarëve kontrollues të shoqërisë Re Consult Infrastrutture S.p.A me objekt përfitim të kontrollit indirekt të 44.8% të kapitalit aksionar në shoqërinë Target A4 Holding S.p.A; si dhe ndërmjet shoqërisë Abertis Infraestructuras S.A dhe Intesa Sanpaolo S.p.A me objekt përfitim të kontrollit indirekt të 6.5% të kapitalit themeltar në shoqërisë A4 Holding S.p.A. marrëveshjet të cilat përbëjnë së bashku transaksionin e përqendrimit, janë nënshkruar më datë 9 Maj 2016. Përqendrimi është njoftuar për shkak të xhirove që realizon shoqëria A4 Holding S.p.A e cila kontrollon Serenissima Costruzioni S.p.A, nëpërmjet degës së saj Serenissima Costruzioni Tirana Sh.p.k në Shqipëri.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Abertis Infraestructuras S.A:** është shoqëria mëmë e grupit ndërkombëtar (“Abertis Group”), aktive në menaxhimin e autostradave me pagesë dhe në fushën e infrastrukturave të telekomunikacionit satelitor dhe tokësor, etj.
- **A4 Holding S.p.A:** është shoqëria mëmë e grupit (“A4 Holding”), operon në fushat e menaxhimit të autostradave me pagesë, ndërtimin e infrastrukturave, pasurive të patundshme dhe telekomunikacionit, etj. A4 Holding S.p.A e cila kontrollon Serenissima Costruzioni S.p.A është prezente në Shqipëri nëpërmjet degës së saj Serenissima Costruzioni Tirana Sh.p.k

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 2 , 10, pika 1.b) dhe 12 të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al